



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

20 Qershor 2022
Nr. 16 Prot.

Drejtuar: Z. Ceno Klosi,
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Rruga Gjin Bue Shpata, Tirana 1000

I nderuar z. Klosi

Në vijim të shkresës suaj me nr. 21870/1 datë 09.03.2022, e cila ka ardhur në përgjigje të letrës së Dhomës Amerikane e Tregtisë (në vijim referuar si "Dhoma") me nr. 32 datë 07.12.2021 në lidhje me propozimet për ndryshime ligjore dhe problematikat e hasura mbi procesin e fiskalizimit, konstatojmë se lista e problematikave të identifikuar dhe raportuar nga anëtarët tanë janë të shumta dhe nuk kanë gjetur ende një zgjidhje përfundimtare.

Më konkretisht, këto problematika lidhen me gabime teknike në platformën qendrore të cilat sjellin pasaktësi në të dhënat e faturimit dhe rrjedhimisht dhe në procesin e fiskalizimit. Edhe pse anëtarët e Dhomës i kanë adresuar vazhdimisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve problematikat e identifikuar, vëjmë re se ato nuk janë zgjidhur dhe problematika të reja vazhdojnë dhe shfaqen në vijim.

Përsa më sipër, Dhoma gjykon se problematikat teknike që ka platforma qendrore janë të shumta dhe mosfunksionimi i plotë i saj e bën të pamundur realizimin e plotësimin automatik me të dhëna të sakta të librave të shitjes apo blerjes, si dhe të deklaratës së TVSH-së, të cilat aktualisht dorëzohet manualisht nëpërmjet llogarive në e-filing.

Pra, për ti dhënë më shumë kohë administratës tatimore në zgjidhjen e problematikave teknike të parashtruara, sugjerojmë se dorëzimi i deklaratës së TVSH-së dhe librave të blerjes dhe shitjes duhet të vijojë nëpërmjet llogarive në e-filing, siç behet aktualisht. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të informojë në rrugë zyrtare tatimpaguesit për zgjatjen e afatit të dorëzimit në e-filing, të librave të shitjes dhe blerjes dhe deklaratës së TVSH-së edhe për 6 - muaj të tjerë.

Duke ju falenderuar për vëmendjen dhe mirëkuptimin, mbetemi në pritje të përgjigjes suaj,

Me respekt,

Drejtori Ekzekutiv
Neritan Mullaj



T.: +355 4 225 9779 www.amcham.com.al

